



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2514, datë 06.11.2014

Për

**“Revokimin e Licencës së Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare
Nr.12, datë 21.09.2012, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të
Shtypit” sh.p.k.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

- *Revokimin e Licencës së Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr.12, datë 21.09.2012, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k.*

BAZA LIGJORE:

- Ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7/1 si dhe gërma c), pika 4 e nenit 18;
- Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 121 e në vijim;
- Rregullore Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, e ndryshuar, gërma d), pika 2, neni 8;
- Rregullore Nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, Kreu II;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt-vendimi;
- Relacioni shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*)
- Dokumentacioni mbështetës:
 - o Kopje e Licencës së Përgjithshme Lokale Nr.12, date 21.09.2012 të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k.;
 - o Kopje e dokumentit Nr.8 prot, datë 31.03.2014 nga “Agjensia e Abonimeve të Shtypit” ku ka dërguar Formularin 14 - “Të dhëna për shërbimet postare të ofruara për periudhën 01.01.2013-31.12.2013”;
 - o Kopje të Memos datë 23.06.2014 me lëndë “Mbi ofruesit e shërbimeve postare, Agjensia e Abonimit të Shtypit dhe Postalink sh.p.k të cilët nuk kanë dërguar të dhëna mbi treguesit statistikore dhe financiare të shërbimeve postare për vitin 2013.”
 - o Kopje e shkresës me Nr. 1684 Prot., datë 04.07.2014 me lëndë “Dërgim Njoftimi” Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k.

si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

- Agjensia e Abonimit të Shtypit sh.p.k deri tani nuk ka filluar aktivitetin për të cilin është licencuar për ofrimin e shërbimeve postare duke mos plotësuar kushtin e ofrimit të shërbimit brënda një viti nga data e marrjes së licencës si dhe nuk ka dërguar asnjë të dhënë statistikore dhe financiare të shërbimeve postare për vitin 2012 dhe vitin 2013.
- Agjensia e Abonimit të Shtypit sh.p.k. në dokumentin e dërguar me Nr. 8 prot, datë 31.03.2014 “Formulari 14” - “Të dhëna për shërbimet postare të ofruara për periudhën 01.01.2013-31.12.2013”, në të cilin nuk ka plotësuar asnjë të dhënë, ka deklaruar që për vitin 2013 nuk ka ushtruar aktivitet për ofrimin e shërbimeve postare.
- Nisur nga fakti i mësipërm, sipas përcaktimit në gjurmën d), të pikës 2, të nenit 8 “Revokimi i Licencës së Përgjithshme, të Rregullores Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1532, datë 18.03.2011 i ndryshuar, AKEP-i revokon një “Licencë të Përgjithshme” me nismën e vet, në rast se vërtetohet që: *Ofruesi i shërbimeve postare nuk ushtron (fillon) aktivitetin, e përcaktuar në “Licencën e Përgjithshme”, brenda një viti nga dita e marrjes së “Licencës së Përgjithshme*
- AKEP, bazuar në faktin juridik të përmëndur më sipër, filloi procedurën për revokimin e Licencës së Përgjithshme të shërbimeve postare, në zbatim të së cilës me shkresën Nr. 1684 Prot., datë 04.07.2014, me lëndë “Dërgim Njoftimi”, bëri me dije Ofruesin e Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k, për fillimin e procedurave për revokimin e Licencës të Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr.12, datë 21.09.2012 me të cilën është pajisur nga AKEP.

“Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k nuk i është përgjigjur njoftimit të sipërpërmendur.

- Ofruesi i Shërbimit Postar “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k. nëpërmjet mosushtrimit të aktivitetit nga data e caktuar për fillimin e tij ka përbushur kushtin ligjor për revokimin e Licencës së Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr.12, datë 21.09.2012, të parashikuar në nenin 8, pika 2, gërma d) të Rregullores Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”
- Nga pikëpamja formale procedurale, dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Rregulloren Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1532, datë 18.03.2011 e ndryshuar, gërma d), pika 2, neni 8;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë faktet e përmendura dhe arsyetimin juridik për revokimin e Licencës së Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr.12, datë 21.09.2012, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k.,

V E N D O S:

1. Të revokojë Licencën e Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr.12, datë 21.09.2012, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Agjensia e Abonimit të Shtypit” sh.p.k.
2. Të njoftohet subjekti Agjensia e Abonimit të Shtypit sh.p.k për nxjerrjen e këtij vendimi.
3. Ngarkohen drejtoritë e AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.
5. Kundër këtij Vendimi palët e interesuara mund të ankimohen brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit apo publikimit në faqen Web të AKEP

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**